



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

PROJEKT VENDIM

Nr. 06, datë 02.09.2022

**“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES TË BUXHETIT TË BASHKISË
VAU DEJËS PËR VITIN 2022”.**

Ne mbështetje të nenit 9 pika 1.3 shkronja “c”, nenet 18, 54shkronja “dh”, neni 55 pika 3, neni 64 shkronja “c”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ;nenit45 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; Ligji 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” neni 100 rishpërndarja e fondeve buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore: a) ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësive të vetëqeverisjes vendore. Vendim i Këshillit Bashkiak nr 72 prot me datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me shprehje ligjshëmërie nga Prefektura Shkodër me nr 12/1 prot dhe datë 14.01.2022. Udhëzim plotësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022”. Sipas relacionit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë; shkresë Nr. 16040 prot. dt. 29.08.2022 “Dërgohet fondi i rritjes së pagave për funksionin e arsimit parashkollor.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rishpërndarjes së buxhetit të vitit 2022, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Formatit nr 1 Plani i të ardhurave të veta
 - b) Formatit nr 2 Fondi për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor
2. Këto projekte do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

Konceptoi:
Albert Ndoci

KRYETAR
MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E EKONOMIKE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCES

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" VauDejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@yaudejes.gov.al

RELACION FINANCIAR

Mbështetur të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.35, datë 21.09.2020, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare" Ligjin nr. 3/2022, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2020, në kuadër të instrumentit të Asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)"; VKM-në nr. 157, datë 17.03.2021, "Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, për programin vjetor të veprimit për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II)"; ju informojmë se Bashkia Vau Dejës ka aplikuar në thirrjen EU for social –economic development (as alternative to drugs cultivation and trafficking phase 2, me nr reference EuropaAid/173618/DD/ACT/AL me projektin me Titull "Vau Dejës si një destinacion turistik". Në kërë thirrje Bashkia Vau Dejës është kualifikuar fituese dhe në datën 08.07.2022 është nënshkruar kontrata e grantit me nr 2022/434-522, e lidhur ndërmjet Bashkisë Vau Dejes në cilësinë e "koordinatorit" dhe Bashkimit Evropian, Delegacioni në Shqipëri në cilësinë e "autoritetit kontraktues", si dhe Qendra për promovimin e Konkurrueshmërisë, në cilësinë e "partnerit". Bashkia Vau Dejës për realizimin e këtij projekti duhet që të mbulojë mbështetjen me TVSH të aktiviteteve (operative dhe kapitale), si më poshtë: Është pakësuar fondi për investimin me kod 1570625 në vlerën 3 696 678 lekë mbasi ishte e domosdoshme dhe urgjente sigurimi i fondit për bashkëfinancimin me fondin e Bashkimit Evropian dhe janë shtuar si më poshtë për planet nga të ardhurat e bashkisë:

- TVSH për shpenzime operative për bashkëfinancim në projektin "Vau Dejës si një destinacion turistik" – 2.140.368.00Lek
- TVSH për shpenzime kapitale për bashkëfinancim në projektin "Vau Dejës si një destinacion turistik"- 939.400.00Lek

Në formatin nr. 2 "Fondi për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor" është rishperndar fondi me vlerën 907 404 lekë i ardhur me shkresën Nr. 16040 Prot. datë 29.08.2022 , sipas zerave dhe programit perkates të buxhetit.

Konceptoi :

Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Finances

Albert Ndoci

Formati nr 1: Plani i Te Ardhurave te veta

PAKËSOHET

Në Lekë

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kodi i Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti 2022	Kodi	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejës	05	09120	2310000	3333	3,696,678.00	1570625	Sistemi dhe rrethim i fushës së sportit në shkollën Naraç+Mbikqyrje+Kolaudim
TOTALI								3,696,678.00		

SHTOHET


Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kodi i Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti 2022	Kodi	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejës	05	06140	2300000	3333	616,910.00		Hartim PDV zona BU-UB- 409 dhe BU-UB-407
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejës	05	04130	6020000	3333	2,140,368.00	9999999	TVSH për shprehje operative për bashkefinancim në projektin "Vau Dejës si një destinacion Turistik"
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejës	05	04130	2310000	3333	939,400.00		TVSH për shprehje kapitale për bashkefinancim në projektin "Vau Dejës si një destinacion Turistik"
TOTALI								3,696,678.00		

Nënpunës Zbatues

Albert Ndoci

Nënpunës Autorizues

Mark Babani



Formati nr 2: Fondi per rritjen e pagave per funksionin e arsimit parashkollor

PAKËSOHET

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kodi i Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti 2022	Kodi	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejës	01	09120	6040000	3333	907,404.00	90007AA	
			TOTALI					907,404.00		

SHTOHET

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kodi i Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti 2022	Kodi	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejës	01	09120	6000000	3333	755,868.00	90007AA	
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejës	01	09120	6010000	3333	151,536.00	90007AA	
			TOTALI					907,404.00		

Nënpunës Zbatues
Albert Ndoci



Nënpunës Autorizues
Mark Babani

